



Institute for Hybrid Warfare Studies

ctopus



**SULMI TERRORIST SERB NË BANJSKA DHE
IMPLIKIMET RAJONALE DHE
GJEOPOLITIKE**

**SERBIAN TERRORIST ATTACK IN
BANJSKA AND REGIONAL AND
GEOPOLITICAL IMPLICATIONS**

AUTORËT/AUTHORS:

AGIM

MUSLIUARTA

HAXHIXHEMAJLI TAULANT

ELSHANI

ORGANIZATORE/ORGANIZAT

OR:

DRILONA FAZLIU

**TETOR 11, PRISHTINË,
2023**

Analizë e Institutit Octopus për sulmin terrorist serb në Banjska dhe implikimet regjionale dhe gjeopolitike

Hyrje

Serbia që nga zanafilla e formimit të shtetit të saj ka qenë dhe ka mbetur shtet i papërfunduar për shkak të konflikteve të brendshme politike, të cilat çonin deri te kontestimi i të gjitha kushtetutave para se të aprovoreshin. Asnjëra nga të gjitha 15 kushtetutat deri më sot nuk është pranuar si e qëndrueshme, dhe nuk ka mundur të vendoset në kuadrin ligjor.

Shtet i papërfunduar nënkupton ambiciet për territore dhe për hegjemoni rajonale që elita politike dhe shoqërore në Serbi ende ushqen. Serbia punon aktivisht në krijimin e Botës Serbe, ide e mbështetur nga Kisha Ortodokse Serbe dhe Akademia Serbe e Shkencave dhe Arteve, si dhe e risjellur në vëmendje së fundmi nga Aleksandar Vullin, duke shprehur haptaz ambiciet territoriale dhe idenë e shkatërrimit të disa shteteve të rajonit, nga ku më të rrezikuarat vazhdojnë të mbeten Kosova, Mali i Zi si dhe Bosnjë-Hercegovina.

Shkak edhe më i madh i shtetit të papërfunduar është edhe mospranimi i kufijve në të cilin gjendej Serbia duke llogaritur edhe kufinj të sotëm. Ky mospranim aktivizonte gjithmonë pyetjen apo përmirësimin e këtyre kufijve në ndonjë luftë të ardhshme.

Në Serbi nuk ka politikë të mirëfilltë, politika Serbe bazohet në sajesa, trillime, gënjeshtër dhe kontroll të opozitës, gjë që krijon frustrim të brendshëm politik, destabilitet të brendshëm politik, por edhe eksportim të krizave sidomos në Ballkan.

Në Serbi nuk ka komunikim politik të brendshëm sepse Serbia është shtet partiak. Partitë në Serbi janë më shumë se organizim politik, që do të thotë se janë pushtet, pasurim, kontroll i shoqërisë, krijim i klaneve, klientelizëm, dhe korrupsion.

Si rezultat i konflikteve të brendshme, Serbia karakterizohet me dhunë të brendshme dhe vrasje politike të udheheqësve të tyre, që nga Karagjorgje, deri te Xhingjiq.

Faktori tjetër që ishte shkak i dhunës dhe faktor politik në jetën e Serbisë ishte ushtria, policia, dhe shërbimet sekrete.

Serbia historikisht është eksportues i dhunës dhe terrorizmit, që nga formimi i “Crna Ruka”, organizatë terroriste e cila vrau Mbretin Ferdinand, akt pas të cilit filloi lufta e Parë Botërore.

Serbia si eksportues dhune në Ballkan dhe krijimi i njësive paramilitare terroriste

Që atëherë e deri më sot, institucionet e sigurisë së Serbisë kanë rekrutuar, trajnuar, dhe mbështetur grupe terroriste, paramilitare, dhe kriminale, për arritjen e qëllimeve politike, qofshin ato të brendshme apo të jashtme.

T'i përmendim disa nga vitet 90të e deri më sot:

1) Grupi i Serbëve të Fushë Kosovës: Mirosllav Sholleviq, Kosta Bullatoviq, Boshko Budimiroviq, etj. Këtë grup e udhëhiqte shërbimi sekret Serb "SDB" si nga përktrahja materiale, ashtu edhe ajo politike. SBD-ja ofronte këshilldhënie, informacione, logjistike, si dhe instruksione për organizim e mitingjeve dhe rrëzimin e pushteteve.

2) Në Nova Pazova krijohet edhe një parti me karakteristika paramilitare: "Srpska Narodna Obnova" që udhëhiqej nga Mirko Joviq dhe Vojisllav Sheshel.

3) Në Kroaci rebelimi i policëve serbë në Knin nën udhëheqjen e Millan Martiq, ku sigurimi shtetëror serb fillon organizimin e rebelimit në krahinën e Kninit me vendosjen e barikadave dhe rojeve deri te armatimi i serbëve. Këtë operacion e udhëheqte Franko Simatovic a.k.a "Frenkie". Frenkie sjell edhe instruktorët e sigurimit shtetëror dhe paramilitarë tjerë, të cilët formojnë njësitë paramilitare "Kninxhe", shumica e të cilëve pastaj rekrutohen në NJSO të MUP-it të Serbisë, apo siç quheshin ndryshe "Beretat e Kuqe" dhe "Frenkijevcat".

4) Padyshim që grupi paramilitar "Tigrat" ishte grupi më me nam dhe udhëhiqej nga Zhelko Razhnjatoviq a.k.a "Arkan". Ky dhe të tjerët të cilët ishin rekrutuar nga sigurimi shtetëror serb, ishin kriminelë me renome botërore dhe financoheshin nga po i njëjti shërbim. Shumica e kësaj njësie u rekrutua në JSO apo "Beretat e Kuqe", njësi e cila ka kryer krime në Kosovë dhe Bosnje.

Duke ju falenderuar politikanëve, pasardhësve të Millosheviqit; Koshtunica, Vuçiq, Daçiq, etj, shumicës së këtyre grupeve i është mundësuar t'i mbajnë pozitat e tyre.

Pas luftës në Kosovë, se pari formohen "Rojet e Urës", pastaj "Civilna Zastita", "Brigada e Veriut", dhe disa grupe tjera.

Të gjitha këto grupe janë formuar, udhëhequr, dhe mbështetur nga shteti Serb, respektivisht nga shërbimi sekret "BIA", policia e Serbisë, dhe ushtria e Serbisë. Këto grupe që nga viti 2000 e deri më sot ishin në shërbim të shtetit të Serbisë në aspektin e destabilizmit të Republikës së Kosovës dhe cënimin e sigurisë së saj.

Ta përmendim vitin 2001, pastrimin etnik të veriut të Mitrovicës, vrasjet e shumta të shqiptarëve dhe përndjekja e tyre nga veriu i Mitrovicës;

Bllokada të shumta të rrugëve, demonstrata të dhunshme, kërcënime, vrasje edhe ndaj shqiptarëve edhe ndaj serbëve (Oliver Ivanoviq);

Ishin pjesëmarrës në djegien e pikës kufitare në vitin 2008 dhe në vrasjen e policëve të Kosovës në vitin 2011;

Vendosja e barikadave në fundvitin e kaluar ishte një rebelim i armatosur ku ishin prezentë edhe pjesëtarët e “Wagner”-it, grupit mercenar rus;

Në muajin Maj 2023, në demonstrata të dhunshme në katër komunat veriore të Kosovës u plagosën shumë policë të Republikës së Kosovës dhe mbi 40 ushtarë të KFOR-it.

Pas këtij organizimi dhe shfaqjeje të dhunës ekstreme, Qeveria e Republikës së Kosovës këto organizata i shpalli organizata terroriste, për shkak të veprimtarisë së tyre.

Në terren, kordinimin politik dhe veprimet e këtyre organizatave terroriste, Presidenti i Serbisë Aleksandar Vuçiq e kontrollon nëpërmjet partisë “Lista Srpska”.

Në fakt Lista Srpska është ajo që e kontrollon komplet jetën e përditshme dhe atë politike në pjesën veriore të Kosovës, të banuar me shumicë Serbe.

Gjatë kohës së pasluftës e deri më sot, Serbia ka ndërtuar rreth kufirit të Kosovës 20 baza policore dhe 28 baza ushtarake. Në këtë mënyrë, ndikon gjithmonë në tensionimin e situatës në veri duke provokuar autoritetet e Republikës së Kosovës.

T’i përmendim dy rastet e kidnapimit të policëve nga territori i shtetit të Kosovës, qytetarëve, etj.

Duke inkurajuar gjithmonë grupe kriminale në kontrabandë dhe vepra kriminale.

Vitin e kaluar disa qindra policë të komunitetit serb, sipas urdhërit të Aleksandar Vuçiq nëpërmjet Lista Srpska-s, dhanë dorëheqje.

Po nga viti 2022, qeveria e Serbisë fillon stërvitjen e grupeve diversanto-terroriste nëpër kampe stërvitore ushtarake-policore.

Këto stërvitje i planifikon, mbikëqyr, dhe implementon kreu i Ushtrisë Serbe, policia, dhe Shërbimi Sekret - BIA.

Në 24 shtator 2023, një grup i tillë diversanto-terrorist, hyn në Kosovë me qëllim që të krijojë incidente fillestare me qëllim të përhapjes së konfliktit në tërë Kosovën, ku si pasojë tentohej të shkëputej veriu i Kosovës dhe t'i bashkangjitej Serbisë.

Udhëheqës i këtij grupi ishte Millan Radoičiq, nënkryetar i partisë politike serbe Lista Srpska.

Millan Radoičiq, një kriminel i njohur për autoritetet e sigurisë në Republikën e Kosovës dhe i shpallur në listë të zezë të SHBA-ve dhe Britanisë së Madhe, është “Arkani” i Vuçiqit sot.

Ky grup i armatosur kishte armatim dhe pajisje të sofistikuar ushtarake me vlerë afërsisht 5 milionë euro. Një pjesë e këtij armatimi ishte fshehur dhe ruajtur në Kishën e Banjskës, ku ndodhi edhe i gjithë incidenti ku u vranë disa terroristë serbë dhe Heroi i Republikës së Kosovës, polici Afrim Bunjaku. Ky grup arriti të ikte në drejtim të Novi Pazarit me shumë të plagosur, ku në kufi i prisnin veturat dhe helikopterët për evakuim.

Ndikimi i Kishës Ortodokse Serbe

Kisha Ortodokse Serbe luan një rol të madh në politikën e Serbisë, sidomos në identitetin nacional dhe politikë të jashtme, kështu që ndikimi i saj është shpeshherë shumë kontravers. Ndikimi i saj shihet në tendencat e ndalimit të zhvillimit liberal të shoqërisë serbe, apo në tendencat e ndarjes së religjionit, respektivisht Kishës Ortodokse Serbe nga ndikimi në politikën shtetërore. Ndikimi i saj agresiv shtrihet në të gjitha territoret e Ballkanit ku jetojnë serbët.

Mund të themi që Kisha dhe udhëheqësit e Kishës Ortodokse Serbe gjithmonë kanë qenë edhe frymëzues së luftërave të Serbisë dhe kriminelëve të luftës siç janë Slobodan Milosheviq, Ratko Mladiq, Arkani, Radovan Karaxhiq, etj.

Kjo më së miri shihet edhe në rastin e fundit të Kishës Ortodokse në Banjskë, e cila ishte në bashkëveprim me grupin diversanto-terrorist.

Ndikimi Rus dhe i propagandës Ruse në Serbi

Ndikimi i politikës ruse dhe propagandës së mediave ruse në Serbi shihet në çdo hap. Të gjitha mediat me ndikim në Serbi çdo ditë transmetojnë dhe përhapin narrativën ruse të luftës dhe armiqësisë perëndimore. Elitat politike të Serbisë në krye me Aleksandar Vuçiq i përkrahin ato.

Sipas një ankete, 66% e qytetarëve të Serbisë mendojnë se Perëndimi është përgjegjës për luftën në Ukrainë, kurse 21% mendojnë që Rusia është fajtores. Vetëm 3% mendojnë që Ukraina është

fajtores. Kjo sipas studimit të OJQ-së Serbe “Novi Treqi Put”. Sipas kësaj organizate, 47.5% të anketuarve mendojnë që Rusia është partneri politik kryesor i Serbisë, 30% mendojnë që Bashkimi Europian është partneri kryesor, kurse 19% mendojnë që është Kina.

Në anën tjetër, 51% Bashkimin Europian e shohin si mbështetës ekonomik të së ardhmës, 26% mendojnë që është Kina, kurse 21% mendojnë që është Rusia.

Ky mendim është i ngjajshëm edhe në vendet tjera ku jetojnë Serbët, sidomos në Republika Srpska në Bosnje Hercegovinë. Kur kanë interes personal, njerëzit në Serbi nuk kerkojnë punë në Rusi e as nuk shkojnë për të studiuar në Kinë, por në Perëndim.

Kur është në pyetje politika zyrtare, njerëzit në Serbi janë të bindur që Rusia dhe Kina janë të mirët, kurse Perëndimi i dëshiron të keqen Serbisë, thotë në një studim Tomas Brai, nga Fondacioni “Friedrich Nauman”.

Rolin kyç në shpërndarjen e këtyre narrativave për Serbi, e cila është edhe narrativa e politikës zyrtare të Rusisë, kanë mediat propaganduese Ruse “RT (Russia Today)”, dhe “Sputnik”.

Këto media kanë redaksitë e tyre të etabluara mirë në Beograd dhe përhapin propagandën Ruse në baza ditore.

Ekziston lidhje tradicionale Ruso-Serbe qysh nga kohërat e luftërave Ballkanike, e deri te luftërat e fundit në ish-Jugosllavi.

Rusia gjithmonë prezantohet si shtet vëllazëror i Serbisë, e që automatikisht i kyç edhe të gjitha pikat kulturore siç janë gjuhët sllave dhe feja Ortodokse.

Një prej pikave kryesore të propagandës ruse është aktualizimi i tensioneve ndërnacionale në Ballkan, ku Rusia është gjithmonë në anën e Serbisë, e sidomos kur bëhet fjalë për Kosovën.

Në praktikë më së miri shihet p.sh. në luftën në Ukrainë sipas titujve që vijnë nga Kremli;

- “Fillon rendi i ri botëror - Putin shkatërroi EU dhe NATO” (Srpski Telegraf, 15.11.2016).
- “Blitzkrieg - Uragani Rus shkatërroi Ukrainën - Putin për një ditë arriti në Kiev” (Alo, 25.02.2022).
- “Fashisti love Serbiu - A Evropa cuti igleda”(Informer,16.01.2023-Tema Kosova), etj.

Vuçiq e ka kontrollin absolut në mediat më me ndikim në Serbi, ai zyrtarisht deklaroi politikë bashkëpunuese me EU, dhe që Serbia është kandidat për anëtar të EU-së duke u munduar që të tërheq sa më shumë investitorë në Serbi.

Serbia nuk i ka përkrahur sanksionet kundër Rusisë në rastin e invadimit të saj në Ukrainë. Aleksandar Vuçiq luan gjithmonë me politikën e “kolovajzës” duke marrur pozicion në mes dy blloqeve të Perëndimit dhe Lindjes.

Në këtë politikë është i suksesshëm në Perëndim sepse i mashtron gjithmonë, por në fakt çdo reformë më serioze në Serbi, çdo tentim i luftimit të korrupsionit do të rrezikonte pozitën e Vuçiqit në Serbi. Andaj, nuk është reale që të pritët të ketë ndryshime politike nga ana e pushtetit dhe Vuçiq në Serbi.

Koncepti politik i Perëndimit i bashkëpunimit pa kushte me të ashtëquajturit “Stabilokratët në Ballkan” është gabim i madh i Perëndimit sepse Vuçiq nuk bën asgjë tjetër përpos që është një autokrat dhe kopjon sundimin e Putinit në Rusi.

Ky kontroll më së miri shihet në kontrollin e mediave, drejtesisë, ushtrisë, policisë, e sidomos shërbimeve sekrete si dhe eliminimin e konkurrentëve politikë.

Me faktin që BE-ja është investitori më i madh në Serbi si në tregti ashtu edhe në partneritet financiar, atëherë duhet që politikat e BE-së dhe perëndimet të kushtëzohen me reforma në shoqëri duke i përdorur instrumentet konkrete në dispozicion.

Lista SRPSKA dhe ndikimi i saj në veri

Kur forcat e NATO-s me emrin e përbashkët KFOR filluan të hyjnë në territorin e Kosovës pas përfundimit të luftës me datën 12 qershor 1999, kontrolli ushtarak në Kosovë u nda në pesë zona të ndryshme:

- Zona e parë nga Britania e Madhe përfshinte kryeqytetin Prishtinën dhe pjesët e tjera veri-lindore.
- Zona e dytë nga Franca përfshinte Mitrovicën dhe pjesë të tjera veri-perëndimore.
- Zona e tretë nga Italia përfshinte Pejë dhe pjesët e tjera jug-perëndimore.
- Zona e katërt nga Gjermania përfshinte Prizrenin dhe pjesë të tjera jug-lindore.
- Zona e pestë nga SHBA përfshinte Gjilanin dhe pjesë të tjera lindore.

Federata Ruse kishte shprehur ambicie para përcaktimit të komandimit të zonave nga KFOR-i që të kontrollonte Zonën e dytë, ku është Mitrovica dhe pjesë të tjera veri-perëndimore të Kosovës.

Kjo ambicie u refuzua nga NATO-ja dhe partnerët dhe përfundimisht u vendos që Zona e dytë të komandohet nga forcat ushtarake franceze. Çfarë pasoi pas ndarjes së komandimit të zonave është që Zona e dytë u shndërrua në strehë për shumë serbë ku tanimë njihet edhe si veriu i Kosovës. Serbët në këtë pjesë, që tashmë do të quhej veriu i Kosovës (pjesa veriore e qytetit të Mitrovicës, Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviqi), rezistonin me forcë që banorët shqiptarë të mos ktheheshin në shtëpitë e tyre.

Disa herë ka pasur konflikte, të cilat për pasojë ka pasur të vrarë dhe të plagosur. Prandaj, forcat franceze, për të parandaluar konfliktet, nuk lejonin që në këtë pjesë të shkonin as civilët dhe as autoritetet e tjera shqiptare duke përfshirë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, e më vonë as organizmin që doli nga demilitarizimi i saj, Trupat Mbrojtëse të Kosovës.

De facto, veriu i Kosovës u shndërrua në territor ku Serbia tashmë po krijonte një zonë të saj të lirshme influence. Përveç kësaj, në këtë zonë shumë shpejt filloi rritja e kontrabandës dhe krimit. Veriu i Kosovës për vite me rradhë u shndërrua në territor ku jetonin vetëm serbët ku disa shqiptarë që ia kishin dalë të hynin në shtëpitë e tyre në pjesën veriore të qytetit, në disa faza të ndryshme, u dëbuan nga aty. Në mes të 2 dhe 20 shkurtit të vitit 2000, 1700 shqiptarë, turq e boshnjakë u dëbuan nga pjesa veriore e Mitrovicës.

Përveç interesimit për të pasur një territor të tyre, serbët e veriut të Kosovës, përveç tjerash paraqitnin një interes tjetër për partitë politike në Serbi. Ata shumë shpejt u shndërruan në votë të manipulueshme, e cila nuk ishte e vogël për pushtet. Beogradi e shihte këtë pjesë edhe si motiv për rritjen e nacionalizmit serbomadh, dhe në emër të investimeve “për ta ruajtur qenien serbe në Kosovë”, qindra miliona euro u keqpërdorën në Serbi.

Gjithashtu, veriu i Kosovës është një temë kryesore e procesit negociator ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, i cili filloi me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian në 2011. Edhe pse Serbia nënshkroi marrëveshje me Kosovën në Bruksel, shumica e tyre nuk u zbatuan.

Autoritet e Kosovës në mënyrë graduale po mundohen të shtrijnë pushtetin e tyre në veri. Herë përmes dialogut në Bruksel, e herë edhe me forcë duke luftuar krimin e organizuar. Pasi që, serbët, duke kundërshtuar shtrirjen e pushtetit në veri, shpeshherë janë përgjigjur me armë, me ç’rast janë vrarë individë të autoriteteve kosovare apo edhe të autoriteteve evropiane.

Kjo pjesë e territorit të Kosovës, forma kriminale se si qeverisej de facto në të shumtën e kohës, prodhoi edhe liderë politikë të ardhur nga krimi. Disa prej tyre u shndërruan edhe në sponsorizues të partive politike në Serbi. Duke fuqizuar financiarisht partitë politike në Serbi, ata fuqizoheshin edhe vet me pushtet. Veçmas, kjo dukuri u shfaq shumë pas vitit 2012, kur në Serbi erdhi në pushtet Partia Përparimtare e Serbisë (SNS), e cila solli edhe Aleksandar Vuçiçin më pas si kryeministër të Serbisë, e më vonë edhe si president. Pas kësaj kohe, serbët e veriut të Kosovës intensifikuan veprimtarinë kriminale.

Megjithëse serbë të veriut edhe më herët ishin aty, SNS pas ristrukturimit të strukturave të sigurisë në Beograd, filloi riorganizimin e serbëve të Kosovës. Gjatë kësaj kohe lindën organizma të rinj politikë e kriminalë të serbët e veriut. U krijua Lista SRPSKA, e cila aplikoi për regjistrim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me emrin “Srbija”, gjë që u refuzua. Fillimisht, kishte një shpresë se Lista SRPSKA do ta aplikonte integrimin e serbëve të veriut, gjë që juridikisht ndodhi. Serbët e veriut dolën në zgjedhje lokale në Republikën e Kosovës për herë të parë më 3 nëntor 2013.

Por, bashkë me integrimin juridiko-politik të serbëve në veri, paralelisht ndodhi presion i paparë tek votuesit serbë për ta sjellë në pushtet Listën SRPSKA kudo në 10 komunat me shumicë serbe në Kosovë. Rezultati i zgjedhjeve lokale të vitit 2013 ishte në favor të Listës SRPSKA. Ajo i fitoi 9/10 komunat.

Përkundër faktit se zgjedhjet në Kosovë secilën herë kanë shkuar duke përmirësuar imazhin demokratik të Kosovës, komuniteti serb në Kosovë, që nga koha kur Lista SRPSKA merr pjesë në zgjedhje, asnjëherë nuk ka përjetuar zgjedhje të lira. Për të dalë fituese e zgjedhjeve, Lista SRPSKA dhe mekanizmat ilegale të Serbisë në Kosovë, kanë përdorur metoda të ndryshme represive, që nga kërcënimet verbale e të shkruara, djegiet e makinave deri te vrasjet.

Pikërisht për motive monopolist politiko-kriminal janë vrarë: kandidati i Partisë Liberale Serbe (SLS) për kryetar Mitrovicës Veriore, në zgjedhjet lokale (2013) Dimitrije Janiçijeviq (me 16.01.2014), dhe gjithashtu, më 16.01.2018 (fiks 4 vite më vonë), kandidati tjetër për kryetar të Mitrovicës Veriore nga partia SDP, Oliver Ivanoviq, pak kohë pas zgjedhjeve komunale në fundvitit 2017.



Pra, në dy palë zgjedhjet e para komunale, në të cilat Lista SRPSKA mori pjesë, në Mitrovicën Veriore është vrarë nga një rival politik serb. Gjersa, në rastin e parë, të Dimitrije Janičjeviqit, qëllimi i vrasjes ishte frikësimi i rivalëve politikë për monopolizim të qeverisjes, në rastin tjetër, atë të Oliver Ivanoviqit, përveç monopolizimit të qeverisjes, ka qenë edhe monopolizimi i kriminalitetit.

Ivanoviq, së paku gjashtë muaj para se të vritej, kishte folur hapur për kërcënimet që kishte marrë për t'u tërhequr nga zgjedhjet që u mbajtën në tetor 2017. Provoi të ankohej edhe te Aleksandar Vuçiq, por siç kishte deklaruar, Vuçiqi mbështetej në qendrat e pushtetit së krimit dhe jo të komunave legale.

Vrasja e Ivanoviqit e kishte bërë më popullor emrin e një njeriu, përfaqësuesin e kriminalitetit në veri. Milan Radoiçiq, i akuzuari kryesor për vrasjen e Oliver Ivanoviqit tashmë kishte fituar mbështetjen e Aleksandar Vuçiqit.

Përkundër akuzave për kontrollin total në veri - për kontrollin e bandave; kontrollin e tenderëve në Serbi dhe projekteve të Serbisë në Kosovë; për kontrollin e buxhetit të Kosovës, të destinuar për komunat veriore; kontrollin e trafikut të narkotikëve dhe monopolin në të; zbatuesin e urdhrave nga Beogradi - ushtrimit të dhunës – kërcënimeve, rrahjeve dhe vrasjeve; kontrollin e politikanëve serbë në Kosovë, veças atyre të Listës SRPSKA, Milan Radoiçiq, me miratimin e Vuçiqit, në qershor të vitit 2018 u “zgjodh” nënkryetar i Listës SRPSKA.

Që nga kjo kohë, herë në petkun e politikanit, e herë të kriminelit, Radoiçiq u bë edhe formalisht njeriu më i besueshëm i Aleksandar Vuçiqit. Milan Radoiçiq i kontrollonte të gjithë të tjerët, kurse ai kontrollohej nga Vuçiqi.

Përfshirja e tij në çdo gjë të keqe në veri, por edhe në Serbi, e bëri Radoiçiqin target jo vetëm të shërbimeve të inteligjencës, të Kosovës e shërbimeve të tjera partnere që veprojnë në vend, por edhe target të mediave. Shumë shpejt ai u bë target edhe i institucioneve të drejtësisë, të cilat njëherë i ngritën aktakuzë për vrasjen e Ivanoviçiqit, e më vonë edhe të përfshirjes së tij në korrupsion.

Vazhdimisht, Vuçiqi e imunizonte dhe mbronte nga të gjitha sulmet. Madje e përkrahte. Vuçiqi e mbrojti Radoiçiqin edhe kur ai u fut në listën e sanksioneve të Departamentit të Thesarit të SHBA-së, më 8 dhjetor 2021.

Disa ditë më vonë, Policia e Kosovës dhe Prokuroria Themelore e Ferizajt e nisën aksionin për arrestimin e disa personave, i njohur si rasti “Brezovica”. Shumë shpejt, edhe Radoiçiq u bë subjekt i hetimit në këtë rast. Që nga fillimi i vitit 2022, përfaqësuesi i Vuçiqit, Milan Radoiçiq, nuk do të bënte më publikisht asnjë aktivitet në territorin e Republikës së Kosovës.

Megjithatë, ai organizoi nga hoteli i tij në Kopaonik, në anën serbe të kufirit Kosovë-Serbi të gjitha aktivitetet kriminale dhe politike. Megjithëse vetëm nënkryetar i Listës SRPSKA, ai ka udhëhequr de facto me këtë subjekt politik. Njeriu kryesor i Vuçiqit, selinë për secilin aktivitet e kishte në Kopaonik. Tek ai mblidheshin të gjithë ata që u jepte urdhra, kurse për t’i marrë urdhrat ai shkonte në Beograd.

Politika e Beogradit filloi të ashpërsohej pas agresionit rus në Ukrainë, në shkurt të vitit 2022. U intensifikuan rekrutimet dhe financimet në kuadër të strukturave ilegale, kriminale, që më vonë do të shpallehin terroriste nga Republika e Kosovës. Organizatat terroriste janë Mbrotja Civile dhe Brigada e Veriut. Pjesëtarët e këtyre organizatave terroriste mbanin trajnime të rregullta në Serbi, në baza të ushtrisë Serbe dhe lokacione të tjera sikurse: Poligonin e kompleksit ushtarak “Pasuljanske Livade” në të cilin trajnohen edhe pjesëtarët e Forcave të Armatosura të Serbisë, terrenin stërvitor të tyre në Peshter, në afërsi të Tutinit në Serbi; poligonin e kazermës ushtarake në Rashkë; në Qendrën e Trajnimeve të Ministrisë së Punëve të Brendshme “Mitrovo Polje” që gjendet në bjeshkë afër Vernjačka Banja dhe Kopaonikut.

Kërcënimet nga Serbia: Sulmi Terrorist në Banjskë / Lidhjet e Grupit me Serbinë

Serbia vazhdon të jetë rreziku më i madh për sigurinë kombëtare të Republikës së Kosovës, duke konsideruar qasjen armiqësore, financimin e strukturave paralele dhe organizatave terroriste që veprojnë brenda territorit të Kosovës, ngritjen dhe shtrirjen e bazave ushtarake përgjatë gjithë vijës kufitare mes dy shteteve, luftës hibride, e sidomos dezinformimit që Serbia ushtron në Kosovë.

Në preambulën e Kushtetutës së Republikës së Serbisë, të miratuar pas referendumit të 8 nëntorit, 2006, Republika e Kosovës konsiderohet pjesë integrale e saj, ku thuhet se “angazhoen të gjitha institucionet për ta mbrojtur atë si brenda Serbisë, po ashtu edhe në politikën ndërkombëtare”.

Në përgjithësi i tërë aparati shtetëror i Serbisë është i angazhuar në sabotimin dhe dëmtimin e Republikës së Kosovës; duke filluar nga institucionet më të larta të vendimarrjes në Serbi, si institucioni i presidentit dhe qeveria, pastaj shërbimet inteligjente, forcat e armatosura, por edhe institucione me ndikim të madh shoqëror, si Kisha Ortodokse Serbe dhe si Akademia Serbe e Shkencave dhe Arteve.

Pas fillimit të agresionit rus në Ukrainë (shkurt 2022), Serbia ka shtuar aktivitetet hibride dhe agresive kundër Kosovës, duke synuar kërcënimin e sigurisë në Kosovë dhe rajon, ndërlidhur me pretendimet territoriale, mbajtjen e situatës në tension të vazhdueshëm (interesat serbo-ruse në rajon për destabilitet / Bota Serbe);

Që nga viti 2022, me intensitet të shtuar, janë ngritur kapacitetet kërcënuese dhe destabilizuese në Kosovë, me theks të veçantë në katër komunat në veri.

U intensifikuan rekrutimet dhe financimet në kuadër të strukturave ilegale, kriminale, tashmë të shpallura terroriste “Mbrojtja Civile” dhe “Brigada e Veriut”.

Pjesëtarët e këtyre formacioneve ilegale, mbanin trajnime të rregullta në Serbi në baza të ushtrisë Serbe dhe lokacione të tjera përfshirë: Poligonin e kompleksit ushtarak “Pasuljanske Livade” në të cilin trajnohen edhe pjesëtarët e FAS, terrenin stërvitor të FAS në Peshter, në afërsi të Tutin/Serbi, poligonin e kazermës ushtarake në Rashkë, në Qendrën e Trajnimeve të Ministrisë së Punëve të Brendshme “Mitrovo Polje” që gjendet në bjeshkë afër Vernjačka Banja dhe Kopaonikut.

Në përpjekjet për destabilizimin e Kosovës, përkatësisht provokimin e trazirave në Kosovën veriore si dhe në aspiratat për aneksimin eventual të kësaj pjese të vendit ka influencë të theksuar edhe Federata Ruse përmes raporteve sistematike me Listën Serbe, dhe instrumentalizimin dhe përdorimin e Serbisë si proxy – duke marrë në konsideratë lidhjet e forta kulturore dhe politike të këtyre dy vendeve. Federata Ruse e përdor Serbinë, duke e shndërruar atë në *proxy state*, për të

arritur objektivat e saj të politikës së jashtme si dhe për të promovuar agjendën e saj politike. Lidhjet e forta të Kremlinit dhe Listës Serbe janë të dëshmuara nga takimi në Moskë i kryetarit të këtij subjekti politik, Goran Rakiq me zyrtarin e lartë të partisë Rusia e Bashkuar, Sergey Zhelenyak.

Pikë kthese drejt ngjarjeve të muajve të fundit shënon padyshim paraqitja publike e Millan Radoiqiq, me datë 05 korrik, 2022 ku përmes një video sfidon hapur autoritetet e Republikës së Kosovës dhe paralajmëron se tani më nga arratia do t'i shtynte përpara idetë e tij. Ai në fjalimin e tij të shkurtër thotë që “tani më nuk ka kthim prapa”.

Barrikatadat e datës 31 korrik 2022

Pjesëtarë të trajnuar nga strukturat serbe të sigurisë, kishin vendosur gjithsej 11 barrikada në lokacione të ndryshme në komunat e veriut të Kosovës. Në barrikada janë parë persona të maskuar, të armatosur dhe me veshje taktike. Lidhur me këtë, presidenti i Serbisë kishte thënë se ata janë “*serbë të rinj dhe të vjetër, që kishin për qëllim mbrojtjen e Kosovës nga agresioni*”.

Ngjarjet nga 18 gusht 2022 e në vazhdim

Pas kësaj date për herë të parë u shfaqën publikisht grafite të “Severna Brigada”. Pastaj grafite me përmbajtje “NATO GO HOME, OVO JE SRBIJA”, pas takimeve të ndara që kryeministri i Kosovës Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq kishin realizuar në selinë e NATO-s në Bruksel. Pas 30 gushtit filloi fushata e organizuar e djegies së makinave të qytetarëve serbë në veri të cilët regjistronin makinat me targa RKS, si formë intimidimi. Më 03 nëntor 2022 u suspendua nga puna në Policinë e Kosovës ish komandanti për veriun Nenad Djuriq, pasi kishte refuzuar urdhërat për zbatimin e vendimeve të Qeverisë së Kosovës. Pas suspendimit të Djuriq, të gjithë policët serbë të veriut në mënyrë kolektive dhe demonstrative dhanë dorëheqje. Pas dorëheqjes nga Policia e Kosovës, të njejtit ishin angazhuar në mënyrë ilegale me detyra të policimit, duke u armatosur, dhe pasi ishin pajisur me uniforma të gjelbërta dhe radiolidhje.

Pas dorëheqjes së kryetarëve të katër komunave veriore u shpallën zgjedhjet e jashtëzakonshme të pjesshme të pushtetit lokal për Leposaviq, Zubin Potok, Mitrovicën e Veriut dhe Zveçan.

Në të njëjtën kohë dorëheqje dhanë edhe zyrtarët serbë të KQZ-së. Një ekipë nga Prishtina planifikoi t'i hapte zyrat në veriun e Kosovës, të cilat pastaj u sulmuan nga tashmë organizata terroriste “Mbrojtja Civile”. Nën dyshimin për sulm kundër zyrave të KKZ-së u arrestua ish zyrtari i Policisë së Kosovës, Dejan Pantiq. Kjo çoi ngritjen e barrikadave të reja.

Barrikadat e datës 10 dhjetor 2022

Serbët shfrytëzuan si pretekst arrestimin e Dejan Pantiq dhe bllokuan të gjitha rrugët në veriun e Kosovës, nga data 10.12.2022 deri më 29.12.2022.

Përsëri vendosën barrikada në komunat e veriut të Kosovës, por me strategji të ndryshme nga barrikadat e korrikut 2022. Pjesa më e madhe e makinerisë që është shfrytëzuar për bllokimin e rrugëve, kanë qenë të mbushura me mjete eksplozive. Në afërsi të barrikadave janë hapur llogore/istikame ushtarake me pozicione të hapjes së zjarrit ku është konfirmuar prezenca e personave të armatosur në këto lokacione.

Sulmet ndaj KFOR-it të datës 29.05.2023

Me datë 29/05/2023, me qëllim të pengimit të punës së kryetarëve të zgjedhur që të futen në Komunë nga orët e mëngjesit, qytetarë serbë fillimisht kanë bllokuar rrugën me vetura civile pa targa, ndërsa turma e protestuesve kanë tentuar që të futen në objektet e komunave Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq.

Me datë 29.05.2023, protesta e dhunshme ka filluar kur KFOR ka kërkuar nga protestuesit që të hapin një koridor për ndërrimin e njësiteve të Policisë së Kosovës.

Shumica e protestuesve të maskuar dhe të dhunshëm, janë identifikuar si pjesëtarë të Mbrojtjes Civile.

Strukturat ilegale dhe kriminale, të financuara dhe dirigjuara nga Serbia, “Mbrojtja Civile”, sulmuan më pas me armë zjarri dhe granata dore KFOR-in e vendosur para objektit të komunës së Zveçanit dhe së paku 93 pjesëtarë të NATO-s u lënduan. Më vonë u gjetën dëshmi të armëve dhe eksplozivit të përdorur në këto sulme.

Sulmet ndaj Policisë, gazetarëve e qytetarëve

Në vazhdimësi u kryen sulme të orkestruara nga Serbia dhe realizuar nga strukturat ilegale/kriminale, sidomos në katër komunat në veri, përfshirë: sulmet ndaj pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, KFOR-it, EULEX-it, gazetarëve, kundërshtarëve politikë të “Listës Serbe”, frikësim të qytetarëve, arrestim të qytetarëve të Kosovës nën dyshimin se kanë bashkëpunuar me institucionet e Kosovës, djegia e veturave të qytetarëve të Kosovës nga radhët e komunitetit serb, fushata propaganduese me incidente ndëretnike (sipas modelit rus), kërcënime, shantazhe, detyrim për tërheqje nga institucionet, etj. Me 13 qershor, 2023 arrestohet nga Policia e Kosovës i shumëkërkuari Milun Millenković, “Lune”.

Shpallja organizatë terroriste

Pas sulmeve të vazhdueshme dhe administrimit të provave të shumta, institucionet e Kosovës ngritën alarmin duke i shpallur organizata terroriste “Mbrojtjen Civile” dhe “Brigadën e Veriut” (Qershor 2023). Pjesëtarët e këtyre organizatave, sipas urdhrave të Serbisë, u vendosën në kazerma të ushtrisë së Serbisë në Rashkë, kur edhe filluan të kryenin me intensitet të shtuar trajnime luftarake.

Kapja e armatimit

Në veri janë realizuar dy operacionet për konfiskim të armëve (23 Qershor dhe 5 Shtator), ku janë konfiskuar arsenal i armëve luftarake, shumica prej tyre prodhim i Serbisë, të dedikuara për organizatat terroriste në veri “Mbrojtja Civile” dhe “Brigada e Veriut”.

Sulmi terrorist i datës 24/09/2023

Bazuar në të dhënat dhe dëshmitë e analizuara deri me tani, rezulton që Serbia drejtpërsëdrejti është përfshirë në sulmin terrorist të datës 24/09/2023. Milan Radoiçiq ka raporte të afërta me Vuçiqin dhe drejtues tjerë të lartë të Serbisë, përfshirë sektorin e sigurisë dhe mbrojtjes. Personat e përfshirë në sulm, janë financuar nga Serbia. Janë trajnuar në Serbi në baza ushtarake dhe terrene të tjera. Armët luftarake që i ka poseduar grupi, janë të prodhimit serb dhe të njëjtat mund të sigurohen vetëm në baza ushtarake. Hartat dhe skicat e gjetura (për pushtimin e veriut), janë hartuar nga ekspertët ushtarakë.

- Milan Radoiçiq (udhëheqës i grupit terrorist në terren), përfaqëson Serbinë dhe jo vetëm grupet e krimit të organizuar që veprojnë në katër komunat në veri. Radoiçiq vepron me direktiva të pushtetit në Serbi, në pajtim me strukturat e sigurisë dhe mbrojtjes së saj.
- Organizimi, mbështetja dhe sponsorizimi i grupit terrorist nga Serbia, është bërë në disa mënyra, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:
 - financimin e tyre;
 - ofrimin e trajnimeve;
 - pajisjen dhe furnizimin me armë dhe municion luftarak (një pjesë e madhe e të cilit mund të gjendet apo sigurohet vetëm në depo ushtarake);
 - ofrimin e ndihmës logjistike dhe të inteligjencës;

- ofrimin e mbështetjes në planifikimin ushtarak të operacionit (të ndarë në faza, për pushtimin e veriut, të paraqitur në harta ushtarake me detaje të veprimeve taktike dhe operacionale);
- mbrojtje, hapësira të sigurta (strehë) duke i lënë që të veprojnë dhe operojnë brenda territorit të Serbisë dhe në brezin kufitar me Kosovën, të uniformuar e të armatosur;
- ofrimin e mbështetjes pas sulmit, strehim, shërim, glorifikim dhe ofrim i mbështetje politike në Serbi dhe Kosovë (Lista Serbe).

- Presidenti i Serbisë Aleksandër Vuçiq, në forma të ndryshme ka udhëzuar Milan Radoiçiqin dhe strukturat ilegale serbe për të mobilizuar persona të rinjë në katër komunat në veri dhe në fund për të formuar edhe grupin terrorist i cili u përfshi në sulmin terrorist të 24 shtatorit. Ky grup vepronte i papenguar në Serbi, në brezin kufitar, duke u toleruar dhe mbështetur nga strukturat e sigurisë së shtetit serb.

- Milan Radoiçiq (udhëheqës i grupit terrorist në terren), përfaqëson Serbinë dhe jo vetëm grupet e krimit të organizuar që veprojnë në katër komunat në veri. Radoiçiq vepron me direktiva të pushtetit në Serbi, në pajtim me strukturat e sigurisë dhe mbrojtjes së saj.

- Milan Radoiçiq, ka marr pjesë pothuajse në të gjitha takimet e presidentit serb Aleksandar Vuçiq me përfaqësuesit serbë të veriut të Kosovës dhe jo vetëm.

- Millan Radoiçiq ndikimin e tij në ushtri e kishte përforcuar pas ardhjes së Milosh Vuçeviqit në pozitën e Ministrit të Mbrojtjes (tetor 2022). Ai ka lidhje edhe me shefin e shtabit të FAS, Milan Mojsilović i cili është me prejardhje nga veriu i Kosovës. Njësitet speciale ushtarake sikurse Kobra janë nën komandën shefit të shtabit të FAS.

- Ndikim të madh Millan Radoiçiq ka edhe në kuadër të strukturave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, rrjedhimisht edhe policisë serbe. Policët që veprojnë në zonën e Rashkës, Novi Pazarit dhe zonat tjera në afërsi të vendit tonë, kishin marrë urdhër të prerë që në rast se ndalohet ndonjë veturë për çfarëdo parregullsie, por që prezantohen si “njerëz të Radoiçiqit” të lirohen menjëherë dhe të mos u kërkohet asnjë dokument. Madje, kohëve të fundit ai kishte caktuar shumë persona të tij të besueshëm në pozita drejtuese atje.




Detaje rreth sulmit terrorist

Bazuar nga të dhënat dhe faktet e mbledhura deri me tani nga institucionet, grupi terrorist (pas trajnimeve të shumta në Serbi/baza ushtarake, të argumentuara edhe nga pamjet e dronëve të grupit), është nisur nga Novi Pazari/Serbi në orët e pasdites së datës 23 shtator.



Në orët e hershme të datës 24.09.2023, duke shfrytëzuar rrugën ilegale e cila ndodhet në afërsi të vendkalimit kufitar të quajtur “Izvor”, e cila është pika më e afërt me qytetin e Novi Pazarit në Serbi dhe fshatin Banjska në komunën e Zveçanit, ata kanë hyrë në vendin tonë dhe shumica kanë ardhur deri në fshatin Banjska të Zveçanit.

Rrugëtimi i tyre është bërë në grupe dhe në mënyrë të organizuar 3-4 vetura kanë vazhduar në drejtim të fshatit Bajkska Zveçan. Distanca nga pjesa e kufirit e deri të Manastiri i Banjskës, është rreth 14 km.




Pjesëtarët e këtij formacioni kriminal dhe terrorist janë pajisur me armë të shkurtra dhe të gjata ushtarake, mjete eksplozive, armë kundër tankeve/anti-tank, automjete të cilat i shfrytëzojnë për nevojat e tyre operative, mjete të ndryshme komunikimi, mjete tjera të nevojshme për vrojtim dhe fotografim, objekte të cilat i shfrytëzojnë si baza dhe për nevoja tjera, si dhe mjete të ndryshme për nevoja logjistike. Kapacitetet logjistike të këtij formacioni financohen dhe sigurohen nga Serbia dhe strukturat e saj të cilat kryesisht hyjnë në Kosovë përmes rrugëve ilegale në veri të vendit.

Lokacioni i përzgjedhur është pozicion strategjik që lidh Leposaviqin me Zvečanin dhe Mitrovicën e Veriut. Gjithashtu, ky lokacion do t'i kishte ndihmuar grupit diversant terrorist ndërlidhjen e shpejtë me Serbinë, me FAS-in, por edhe me kapacitetet mobilizuese të Serbisë që i ka bërë në katër komunat në veri.

Sipas hartave dhe dëshmive të tjera të gjetura nga vendi i ngjarjes, operacioni ka qenë i planifikuar të zhvillohet në tri faza, me gjithsej 43 pika të vendosura në udhëkryqe, vende të larta strategjike (kodra) dhe ura.

Sulmi ka filluar në orët e para të mëngjesit, ku është vrarë rreshteri i PK-së Afrim Bunjaku dhe janë plagosur tre zyrtarë të tjerë të Policisë së Kosovës. Gjatë aksionit anti terrorist, janë vrarë 3 pjesëtarë të grupit.



Qëllimi ishte pushtimi i pjesës veriore, krijimi i një korridori të lirë për transportim masiv të armëve, eskalimi i situatës së sigurisë për të provokuar ndërhyrjen ushtarake (modeli që ka shfrytëzuar Rusia në Ukrainë), megjithatë pas dështimit të planit të tyre me 24 shtator, shumica prej tyre ikin nga veriu, duke u strehuar në Serbi. Presidenti serb Vuçiq të njëjtit i quan ‘heronjë’, duke i mbrojtur përmes deklaratave publike, por njëkohësisht duke iu ofruar edhe mbrojtje institucionale, si dhe duke mos pranuar asnjë formë bashkëpunimi për zbulimin apo procedimin ligjor të këtij sulmi terrorist.

Grumbullimet e ushtrisë së Serbisë përgjatë vijës kufitare

Menjëherë pas sulmit terrorist, Serbia filloi me grumbullimin e ushtrisë në afërsi të vijës kufitare me Kosovën, përfshirë transportimin e artilerisë së rëndë. Përveç kërcënimit direkt për agresion ushtarak ndaj Kosovës, ky mobilizim i forcave të armatosura serbe do të përdoret edhe për t’u dhënë kurajo grupeve terroriste serbe në Serbi dhe Kosovë, për të vazhduar me sulmet.

Vlerësime plotësuese dhe rekomandime

Organizatave terroriste “Mbrotja Civile” dhe “Brigada e Veriut” duhet të shpallen terroriste edhe nga vendet aleate pasi që përbëjnë kërcënim dhe rrezik për sigurinë në rajon.

Duke e parë mbajtjen e trajnimeve të rregullta nga organizata të shpallura terroriste tregon që duhet të ketë presion për ndalimin të këtyre trajnimeve në afërsi të territorit të Kosovës.

Lista SRPSKA duhet të largohet nga dominimi dhe kontrolli nga Beogradi dhe lidhja me kriminel sikurse Radoiqiq. Kjo tregon që funksionaliteti i partisë nuk është për interesa të Serbëve por për interesa vetanake dhe destabilizim të situatës. Nuk paraqet ndonjë frymë politike dhe demokratike vetëm presione dhe kontrollë nga Vuçiq.

Tolerimi i gjatë i Vuçiqit nga bashkësia ndërkombëtare, shantazhimi i tij me potencialin për nisje të konflikteve dhe destabilizim të rajonit sipas interesave të sinkronizuara serbo-ruse, kanë rritur apetitet e Serbisë në rajon, ku kërcënimet reale i pamë gjatë ditëve të fundit në Kosovë – sulmi terrorist në Banjskë.

Serbia dhe Vuçiq, duhet të mbahet përgjegjëse, të sanksionohet menjëherë për agresionin e vazhdueshëm hibrid kundër Kosovës. Kalimi pa ndëshkim i Serbisë në raport me përgjegjësinë që e ka për plagosjen e 93 ushtarëve të KFOR-it, barrkadimin e rrugëve në veri, sulmet e vazhdueshme ndaj institucioneve, gazetarëve dhe qytetarëve (nga strukturat që financohet dhe dirigjohen prej saj në veri), dërguan deri të sulmi terrorist i datës 24.09.2023. Vazhdimi i tolerimit të mëtejshëm, rrezikon seriozisht prodhimin e situatave edhe me kërcënuese për paqen dhe stabilitetin rajonal.

Po ashtu tolerimi i mëtejshëm i ambicieve për hegjemoni rajonale të Vuçiqit, ia mundëson edhe Federatës Ruse që të vazhdojë ta shtrijë influencën e saj përmes Serbisë. Në të njëjtën kohë që Rusia shtrin ndikimin dhe projektin objektivat e politikës së jashtme të saj në Ballkan përmes Serbisë, po ashtu e furnizon edhe me armë moderne, që rrisin ndjeshëm kapacitetin ushtarak të Serbisë.

Të tregohet kujdes i shtuar për inskenimin e sulmeve të mundshme ndaj objekteve religjioze dhe nxitjen e urrejtjes ndëretnike nga shërbimet serbe të inteligjencës si dhe veglave të tyre në Kosovë, me qëllimin e zhvendosjes së vëmendjes nga sulmi terrorist në Banjskë.

Duke marrë në konsideratë provat e pakundërshtueshme për lidhjet e grupit terrorist me lidhshimin politik dhe Forcat e Armatosura të Serbisë ne konsiderojmë se ngjarja e Banjskës ka qenë një agresion i pastër nga ana e Serbisë kundër Republikës së Kosovës, dhe duke e klasifikuar si të tillë bashkësia ndërkombëtare duhet të marrë masa konkrete sanksionuese kundër Serbisë.

References/Referencat

Rfe/rl. "Vdes Polici Enver Zymberi." Radio Evropa e Lirë, July 26, 2011.

<https://www.evropaelire.org/a/24277801.html>.

EULEX. "Audrius Šenavičius Case." EULEX European Union Rule of Law Mission in Kosovo. Accessed October 8, 2023. <https://www.eulex-kosovo.eu/?page=2%2C57>.

EU EOM KOSOVO. "Final Report 2021 EOM Kosovo Municipal Elections - EODS." Final Report, 2021.

<https://www.eods.eu/library/Final%20Report%202021%20EOM%20Kosovo%20municipal%20elections%20-%20ENGLISH.pdf>.

Politika. "Ubijen Odbornik SLS U Kosovskoj Mitrovici." Ubijen odbornik SLS u Kosovskoj Mitrovici, January 16, 2014.

<https://www.politika.rs/sr/clanak/281546/Ubijen-odbornik-SLS-u-Kosovskoj-Mitrovici>.

BIRN Balkans . "Ivanovic Named Radoiçiq as North Kosovo Dark Ruler." Ivanovic Named Radoiçiq as North Kosovo Dark Ruler, February 26, 2018.

<https://www.youtube.com/watch?app=desktop&v=Y060xkdfD3E>.

Danas. "Ko Je Milan Radoiçiq, Koga Kosovske Vlasti Dovode U Vezu Sa Napadom Na Severu." Ko je Milan Radoiçiq, koga kosovske vlasti dovode u vezu sa napadom na severu, September 25, 2023. <https://n1info.rs/vesti/milan-Radoiçiq-kosovo-biografija/>.

Express, Gazeta. "U Arrestua Dje Si I Dyshuar Për Sulm NDAJ Policisë E KFOR'it, ' Lune' Sot Del Para Gjykatës." Gazeta Express, June 14, 2023.

<https://www.gazetaexpress.com/u-arrestua-dje-si-i-dyshuar-per-sulm-ndaj-policise-e-kforit-lune-sot-del-para-gjykatës/>.

Mukulani, Adhuresa. "Armatimi I Sekuestruar Në Veri, Sveçla Publikon Pamjet: Është Përdorur Për Grupet Kriminale Serbe." Sinjali, September 5, 2023.

<https://sinjali.com/dalin-pamje-nga-armatim-i-gjetur-ne-veri-svecla-eshte-perdorur-per-armatimi-n-e-grupeve-kriminale-serbe/>.

09:54, Vojin Radovanović06.07.2022., Vojin Radovanović, Ime, Živa VečekiFudbaler (ni)je roba, Živa Večeki, Fudbaler (ni)je roba, Miša BrkićJohan i Rodoljub, et al. "„Radoiçić Kao Arkan Devedesetih – Gde Su Nas Takvi Štitili, Više Nas Tu Nema" – Parović O Spotu Potpredsednika Srpske Liste (Video)." Dnevni list Danas, July 6, 2022.

<https://www.danas.rs/vesti/politika/radoicic-kao-arkan-devedesetih-gde-su-nas-takvi-stitili-vise-n-as-tu-nema-parovic-o-spotu-potpredsednika-srpske-liste/>.

Rfe/rl. “Kosova Shpall ‘Mbrotjtjen Civile’ Dhe ‘Brigadën e Veriut’ Organizata Terroriste.” Radio Evropa e Lirë, June 29, 2023.

<https://www.evropaelire.org/a/mbrotjtja-civile-dhe-brigada-e-veriut-shpallen-organizata-terroriste-/32482051.html>.

Pinoku. “Strukturat Ilegale Serbe Rrethojnë Me Hekura Komunën e Zubin Potokut, Një Ditë Pas Paralajmërimit Të Vuçiç.” Newsbomb Albania, May 4, 2023.

<https://newsbomb.net/strukturat-ilegale-serbe-rrethojne-me-hekura-komunen-e-zubin-potokut-nje-dite-pas-paralajmerimit-te-vucic/>.

Gedošević, Lana. “‘Nezadovoljstvo i Bes Dostižu Vrhunac’ Vučić Nakon Sastanka Sa Srbima Sa Kim: Ljudi Sa Severa i Juga Su Ogorčeni I Zbog Prištine I Zbog Međunarodne Zajednice (Video).” Blic.rs, April 7, 2023.

<https://www.blic.rs/vesti/politika/vucic-sa-predstavnicima-srba-sa-kosova-nezadovoljstvo-i-bes-dostizu-vrhunac/mpwhvn8>.

Kosovska Policija Zatvorila Jarinje I Brnjak, Srbi Postavili Barikade Kod Zvečana I Leposavića.” 021, December 10, 2022.

<https://www.021.rs/story/Info/Srbija/325400/Kosovska-policija-zatvorila-Jarinje-i-Brnjak-Srbi-postavili-barikade-kod-Zvecana-i-Leposavica.html>.

Cvetković, Sandra. “‘zaobilaženje’ Barikada Na Severu Kosova.” Radio Slobodna Evropa, December 15, 2022. <https://www.slobodnaevropa.org/a/kosovo-sever-barikade/32178057.html>.

**TË GJITHA TË DREJTAT E REZERVUARA NGA INSTITUTI PËR STUDIME TË
LUFTËSHIBRIDE OCTOPUS**

**ALL RIGHTS RESERVED BY THE INSTITUTE FOR HYBRID WARFARE STUDIES
OCTOPUS**